

Prof. Dr. Xhevat LLOSHI

PROBLEMI GJUHËSOR I PËRHAPJES SË KRISHTERIMIT

Përhapja e krishterimit në trevat ku sot flitet shqipja ka qenë një proces i dyfishtë. Nga njëra anë, ishte një mënyrë e re vështrimi për botën dhe njeriun, thelbësisht e ndryshme nga paganizmi i pranishëm prej lashtësie në këto vise, madje sillte me vete edhe institucione të reja, rite e zakone të panjohura, deri edhe veshje të ndryshme e një kalendar të ndryshëm, duke i shoqëruar këto edhe një art i ndërtimit, i pikturës, i muzikës e i zbukurimit. Nga ana tjetër, të gjitha këto risi kërkonin shprehjen e tyre gjuhësore, domethënë leksikun, strukturat sintaksore dhe mënyrat e ndërtimit të teksteve, pasi ekzistenca e një feje është qenësisht një ekzistencë gjuhësore. Prandaj mund të thuhet se në shekujt e parë të erës së re edhe për viset tona ka pasur një problem të madh e të ndërlikuar, që shkurt mund të quhet *krishterimi si gjuhë e re*.

Studiuesit tanë i janë qasur kësaj problematike sidomos lidhur me etimologjinë e fjalëve shqipe dhe kanë dhënë tashmë ndihmesa të vlefshme. Duke qenë kjo një tematikë e ndërlikuar, me shtrirje të gjatë në kohë dhe me mungesa të mëdha të dokumentimit, nuk do të ishte e drejtë që të quheshin vërejtje për ndihmesat e mëparshme ajo çka jep sot e do të japë një rishikim i tyre më pas. Gjithashtu kjo parashtrësë e vogël nuk mëton të sjellë gjëra me rëndësi, por vetëm të tërheqë vëmendjen se këtu ka një punë të gjerë për të bërë nga ana e historisë dhe e gjuhësisë.

Është pa dyshim profesori Eqrem Çabej, që me dorë të sigurt i ka hapur hullitë kryesore për trajtimet gjuhësore edhe në këtë fushë. Duke shqyrtuar me rreptësi shkencore huazimet latine të shqipes (*Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, botuar së pari gjermanisht më 1962, kurse shqip më 1974 në *Studime filologjike* më 1974, nr. 2), Çabej ka arritur në disa përfundime të rëndësishme.

Sipas prof. E. Çabejt, krishterimi u përhap herët në bregdetin ilir. Në kohën e ardhjes së sllavëve, organizimi kishtar në Shqipëri edhe si bashkësi fetare, edhe në liturgji dhe në gjuhën e saj tashmë ishte i formuar.

Terminologjia kristiane me gurrë latine përbën shtresën më të moçme të gjuhës fetare për gjuhën shqipe, më të moçme se shtresa greke dhe me përdorim edhe te elementi ortodoks i vendit.

Me një saktësim të mëtejshëm, ai vëren se ndikimi gjuhësor i latinishtes ka zgjatur rreth tetë shekuj për të kaluar më pastaj te italishtja, prandaj huazimet latine kanë pësuar trajtime të ndryshme sipas ecurisë së periudhave.

Më tej, prej tij janë dalluar latiniteti bregdetar, vazhdim i drejtpërdrejtë nga Gadishulli Italik, kundrejt latinitetit ballkanik, ose një variant i latinishtes në Gadishullin Ballkanik. Marrëdhëniet bëhen të shumëfishta duke marrë para sysh ndërmjetësinë si të greqishtes e të sllavishtes, ashtu edhe të gjuhëve të tjera romane (dalmatishtes e rumanishtes). Dhe së fundi, ka edhe formime të brendshme të shqipes, si: *fëjej*, *kelshejt*, *kungatë*, *mblatuer*, *përdëllej*, *uratë*. Në këtë kornizë tërësore prof. Çabej jep edhe mendimet për burimet e terminologjisë së krishterimit në shqipen.

*Nga latinishtja shqipja ruan disa fjalë të terminologjisë kristiane, duke mbajtur një vend të veçantë në rrethin e gjuhëve romane lindore, një rrethanë kjo që ai e quan me rëndësi për historinë e gjuhës kishtarë latine dhe të përhapjes së saj në anët e Lindjes; p.sh. balshëm<balsamum, bekoj<benedicere, blatë<oblata, dreq<draco, engjëll<angelus, faj<fallum, fe<fides fidem, ferr<infernum, kishë<ecclisia, i krishterë<christianus, kryq<crucem, lter<altare, mallkoj<maledicere, meshë<missa, mëkat<peccatum, mëngjillë<vigilia, mrekuili<miraculum, mung<monachus, ndëjeje<indulgeo, pagëzoi<baptizare, pashkë<pasca, pëgër<paganus, prift<presbyter, shenjt<sanctus, shpirt<spiritus, ungjill<evangelium, virgjën<virginem. Parqiten vetëm në gjuhën shqipe: *ndëshkoj*, *kërshëndella*, *famull*, *përdëllej*, *dullyeja*, *shëndërtat*, *truaj*. Me terma të tillë shqipja merr pjesë si në leksikon roman lindor, edhe në perëndimorin.*

Periudhës latine të krishterimit në Shqipëri i përkasin emrat vetjakë: Pal (*Paulus*), Ndre (*Andreas*), Ndue (*Antonius*), Gjon (*Johannes*), Zef (*Josephus*), Meri (*Maria*), e po ashtu *Mërti*, *Shtjefën* dhe emri i vendit *Shqefën* në Toskëri.

Për *italishten* vërejtja e parë është se shumica e huazimeve latine shtrihen mbi mbarë trevën gjuhësore të shqipes, kurse huazimet italiane shpesh kanë përhapje me kufij dialektorë dhe nuk kanë pësuar po ato ndryshime të thella. Kështu vijnë prej italishtes: *apostull*, *dishepull*, *predk*.

Megjithatë, caqet midis fazës së fundit të latinishtes dhe fazës së parë të italishtes nuk janë të prera, madje të njëjtat fjalë arritën në brigjet lindore të Adriatikut një herë me trajtë latine dhe më vonë, një herë tjetër me trajtë italiane, si psh. *balshëm* dhe *balsam*, *shëkroj* dhe *konskaroj*, *shëlboj* dhe *salvoj*.

Në disa raste fjala bazë e latinishtes është zëvendësuar me një fjalë përkatëse të italishtes, si në rastet: djall (*diabolus-diavolo*), pëgërë (*paganus-pagano*), parriz (*paradisus-paradiso*).

Mendimin se ka pasur një ndikim të dalmatishtes mbi shqipen në lëmin e terminologjisë kishtarë prof. E. Çabej e quan të dyshimtë dhe nuk e pranon për fjalë si: prift, fijan (famull), kumtër, pagëzoi, kumbonë, lter, mreku. Ai gjithashtu nuk gjen tipare të përbashkëta ndërmjet retoromanishtes dhe shqipes në lëmin e gjuhës kishtarë latine.

Për *greqishtën* tabloja paraqitet më e ndërlikuar jo vetëm për arsytet jashtëgjuhësore (prania e ngulimeve greke e romake në trevat tona afërsisht në të njëjtën periudhë dhe në rrethana kulturore të barabarta), por edhe se ka pasur marrëdhënie të ngushta gjuhësore ndërmjet dy gjuhëve klasike, saqë flitet për elementë leksikorë greko-latinë. Prandaj është e vështirë të bëhet ndarja se nga vijnë: *ypeshkv*, *jeremi*, *kem-qem*. Ndërsa kanë hyrë drejtpërdrejt nga greqishtja: *bagëmi*, *djemën* (shumës për: djall). Megjithatë Bizanti ka qenë vatër rrezatimi edhe për disa mjete të leksikut latin të gjuhëve ballkanike, kështu *manalel* (shëndan i madh) është latinizëm që ka hyrë në shqipen me anë të greqishtes së mesme. Huazime më të reja prej greqishtes së mesme e të re janë: *paradhis-parajsë*, *profit*, *idhull*, *kambana*.

Sipas prof. Çabejt, me antagonizmin që zgjati gjithë Mesjetën midis kishës perëndimore dhe lindores gjen shpjegimin fakti, që në leksikon kishtar të shqipes së përbashkët për mbarë gjuhën nuk ka asnjë huazim prej sllavishtes. Edhe elementët latinë që kanë depërtuar në shqipen nëpërmjet sllavishtes ballkanike janë fort të paktë: *kolendra*, *kullana*, *rusica*, *rëshajet*.

Duke i vështruar edhe huazimet greke, edhe elementët greko-latinë, përfundimi përgjithësues i prof. E. Çabejt është se: “Në këto fjalë pasqyrohet lëkundja e Shqipërisë mesjetare midis kishës perëndimore edhe lindores, krejt ashtu si dhe në emrat e shenjtorëve e të muajve: *shëmitër*, *shëmëhill*, *shëndre* etj.” Ndërkaq, ai tërheq vëmendjen për dallimin e huazimeve librore (savante) përbri huazimeve popullore. Në përhapjen e huazimeve librore kisha ka pasur pjesën kryesore, si: *altar*, *adhëroj*, *anatemë*, *aromë*, *doktuor*, *gjendëni*, *idol*, *kretyrë*, *makullë* (njollë), *mëkat murtar*, *pistull* (letër), *tempull*, *unguent*, *fijan* (famull), *kuvend* (manastir), *profet*. Së fundi, për periudhën e shqipes së shkruar vërehet një pasuri më e madhe huazimesh latine, huazime më fort gjysmëlibrore (gjysmësavante) e kryesisht të sferës kishëtare.

Duke u mbështetur në themelet që ka hedhur prof. Çabej, dëshiroj të shtroj disa pyetje, për t’u dhënë atyre përgjigje sipas konceptimit, që krishterimi përbënte një gjuhë të re për trevat tona.

Pyetja e parë është: në cilën gjuhë u përhap në këto treva krishterimi? Deri në vitin 49 të erës së re u bë kthimi në të krishterë vetëm i hebrenjve.

Në Koncilin e Jerusalemit të atij viti Shën Pali mori përsipër të ungjillëzonte paganët në Azinë e Vogël e në Ballkan dhe në letrën e vitit 59 ka shkruar se e ka sjellë ungjillin e Krishtit deri në Ilirik (Dhiata e re, Letra drejtuar romakëve, XV, 19). Në këto fillime gjuha e krishterimit ka qenë greqishtja helenistike. Kjo do të thotë se Pali ka punuar në qendrat ku kishte bashkësi e sinagoga të çifutëve dhe në ngulimet me grekë, por jo në viset që flisnin gjuhën e vendit, domethënë dialektet e ilirishtes jugperëndimore. Me këtë shpjegohet, përse nuk kemi në gjuhën shqipe ndonjë shtresë të lashtë të termave të krishterimit, me prejardhje nga greqishtja. Do të pranojmë që në këtë fazë krishterimi ka gjetur një farë përhapjeje edhe në ngulimet bregdetare me mbisundim të elementit romak, duke u përzier greqishtja me latinishten e folur, por përsëri jo te elementi vendës.

Nga viti 112 e deri më 313, siç dihet, të krishterët u ndoqën nga tetë perandorë romakë, prej Trajanit e deri te Diokleciani. Për arsye të tilla objektive, nuk mund të pranojmë që krishterimi, qoftë greqisht apo latinisht, do të depërtonte në gjuhën e paraardhësve të shqiptarëve gjatë shekujve I-III të erës së re.

Me Ediktin e Milanos më 313 të krishterët fituan të drejtat qytetare e fetare. Prej asaj kohe hyri në veprim pagëzimi, kishat u bënë tempuj të mirëfilltë, duke nisur edhe arkitektura paleokristiane, u vendosën edhe rrobat kishtarë. Si rrjedhim, kur u rishfaq krishterimi në viset tona si fe zyrtare, e qendrës, tashmë vinte nga Perëndimi dhe ishte mbizotërueshëm në gjuhën latine. Për mendimin tim, kërkimi i huazimeve fetare prej latinishtes në gjuhën shqipe duhet të nisë jo përpara, por pas shekullit IV të erës së re. Madje në këtë kohë kishat nisën të ndërtoheshin edhe në fshatra, sigurisht, në zonat me begati ekonomike.

Pyetja e dytë është: në cilat rrethana gjuhësore të pranishme do të depërtonte krishterimi? Përgjigjja më e natyrshme do të ishte, se në rrethanat e dygjuhësisë. Mirëpo kjo do të hamendësohej vetëm për disa qendra të mëdha urbane, por jo për gjerësinë e shtrirjes së trevave të shqipes. Prandaj teza thelbësore, që dëshiroj të nënvizoj, është kjo: ***krishterimi që në fillim erdhi si gjuhë e re, por si gjuhë e re e huaj, madje vijoi të ishte i tillë për më tepër se një mijëvjeçar.*** Për etimologjitë e shqipes kjo do të thotë se ka nevojë për një dallim ndërmjet latinizmave, që kanë ardhur në kushtet e sundimit të gjatë romak, pra dhe të dygjuhësisë me latinishten ballkanike vulgare, kundrejt latinizmave kishtarë, ***të cilat përbënin diçka të re edhe në vetë gjuhën e huaj.*** Latinishtja kishtarë ishte një gjuhë e huaj, që dëgjohej si tekst i plotë në shërbesat dhe jo në bisedën e zakonshme. Këtu kemi një argument për të mbështetur mendimin e prof. E. Çabejt, se disa fjalë të terminologjisë së krishterë të shqipes kanë një vend të veçantë në rrethin e gjuhëve romane lindore. Në viset tona ato vinin si një gjuhë e huaj, ndërsa

për gjuhët romane sidoqoftë ishin një proces e ri brenda gjuhës së tyre. Me këtë besoj se gjejnë shpjegim fjalët: *bekoj*, *kërshëndellat*, *shëndërtat*, që kanë hyrë si togfjalësha e jo si fjalë të shkëputura, domethënë duke qenë në përdorim mes një popullsie që nuk e kuptonte mirë gjuhën prej nga vinin. Kurse sot p.sh., kundrejt *kërshëndella* kemi edhe variantin *Krishtlindje*, te i cili është i qartë dallimi i fjalëve përbërëse, domethënë është një kalkim nga folës që e bëjnë këtë dallim në gjuhën e huaj, domethënë duke e njohur mirë atë.

Shembujt e tjerë të mësipërm të dhënë nga prof. Çabej janë dëshmi bindëse e ndikimit të gjuhës së huaj te një popullsi, që nuk e zotëronte atë. E njëjta dukuri do të ndodhte më vonë me shtresën e arabizmave, që depërtoi në gjuhën shqipe gjatë predikimit të myslimanizmit gjithnjë me një gjuhë, që nuk zotërohej nga popullsia dhe duke mos e pasur Kuranin të përkthyer shqip. Por rast me vlerë të veçantë ndër emërtimet e ditëve të javës përbën fjala *e diel*, që pasqyron lat. *dies solis* dhe i takon si kalkim periudhës pagane para shekullit IV, sepse vetëm në shekullin IV me krishterimin u formua *dies dominica*, sipas greqishtes, ndërsa kjo e fundit nuk mundi ta zëvendësonte emërtimin e mëparshëm të ngulitur në gjuhën shqipe.

Një argument tjetër na vjen nga historia e librit themelore të krishterimit, pra, të Biblës. Në radhë të parë do të vë në dukje se termi 'bibël' nuk del asnjëherë në vetë këtë vepër, ai dëshmohet vetëm që nga shekulli III si një shumës për 'librat', trajtë që më pas u përdor si njëjës. Deri në shekullin IV Bibla njihej për pjesën e parë në greqishten e vjetër sipas përkthimit të Septuagintës që në shekullin III para e.re, ndërsa për pjesën e dytë në greqishten koine helenistike. Eusebius Hieronimi redaktoi në variantin përfundimtar një përkthim latinisht të mbështetur te Septuaginta vetëm në vitin 405. Kështu deri në fund të shekullit IV mungonte edhe kjo vepër bazë e latinishtes fetare të shkruar dhe vetëkuptohet, nuk kishte si të lexohej në kishat e trevave tona qoftë edhe si gjuhë e huaj. Dhiata e re është përgatitur midis viteve 70 dhe 120 të erës sonë. Bibla më shumë se një mijë vjet nuk është lexuar shqip në kishat e trevave tona. Ky është argumenti tjetër se krishterimi vijoi të ishte në një gjuhë të huaj ndër shqiptarët.

Përballë kësaj gjendjeje nuk mund të mos arrij në përfundimin, se përhapja e krishterimit në Shqipëri është ndeshur me dilemën: të mbetej në një gjuhë të huaj, apo të përkthehej në gjuhën e vendit? Për gjuhët neolatine çështja nuk është aq e ndjeshme, sepse ato ishin bija të latinishtes. Për gjermanishten peshkopi vizigot Vulfila ka bërë përkthimin e Dhiatës së vjetër gotisht që në shekullin IV. Për gjuhët sllave menjëherë pas kthimit të tyre në të krishterë, u bënë përkthimet e Cirilit e të Metodit në shek. IX. Mjaftojnë këto referime për të treguar veçantinë e gjendjes për shqipen. Këtu është rasti të kthehemi përsëri te prof. Çabej. Ai tërheq vëmendjen për

dallimin e huazimeve librore (savante) përbri huazimeve popullore. Në përhapjen e huazimeve librore kisha ka pasur pjesën kryesore, si për fjalët *altar, adhëroj, anatemë, aromë, doktor, gjëndëni, idol, kreatyrë, makullë* (njollë), *mëkat murtar, pistull* (letër), *tempull, unguent, fijan* (famull), *kuvend* (manastir), *profet*. Si burim ka shërbyer edhe latinishtja mesjetare, prandaj kemi *kishë* < *ecclesia* në vend të *ecclesia* dhe mungon në shqipen refleksi për *basilica*. Së fundi, për periudhën e shqipes së shkruar (që nis jo më herët se shekulli XII), vërehet një pasuri më e madhe huazimesh latine, huazime më fort gjysmëlibrore (gjysmësavante) e kryesisht të sferës kishtarë.

Për termin *dhiatë*, që e kemi nga greqishtja, gjuhët perëndimore kanë prej latinishtes *testament*, domethënë edhe kjo fjalë është një huazim i vonë te ne dhe nuk ka pasur një praktikë të njohjes së Biblës latinisht si libër me pjesë, që ta nguliste prej kohësh për mbarë shqipen. Tradita e re katolike ka bërë një përkthim tjetër me fjalën ‘Besëlidhja’, duke iu drejtuar hebraishtes ‘berith’, domethënë variantit nga i cili është përkthyer Septuaginta e më pas Vulgata. Edhe këtu do bërë një saktësim. Vetëm pasi u përpunua *Dhiata e re*, u vu emërtimi *Dhiata e vjetër* për pjesën e parë dhe prandaj judaizmi nuk i njeh këta emra. Në gjuhët e tjera perëndimore ‘testamenti’ është përdorur vetëm duke nisur nga fundi i shekullit III. Ndërkaq fjala shqipe *ungjill* vjen prej latinishtes, e cila nga ana e vet vjen prej greqishtes dhe kuptimi ka qenë ‘lajmi i mirë’; kështu interpretuesit e fjalëve nga letrat e Shën Palit duhet ta mbajnë para sysh këtë, kur flitet aty për ungjill, të mos kujtojnë se përmenden ungjijtë e Dhiatës së re, që ende nuk ishin shkruar.

Si kufi kohor na del kështu shekulli IV për huazimet nga latinishtja fetare. Siç dihet, si gjuhë zyrtare latinishtja vijoi në këto treva deri në shek. VII. Ndërkaq fundi i shek. IV është pikërisht momenti i ndarjes së dy perandorive dhe i asaj që quhet sot ‘vija e Teodosit’. Duke e pranuar se në fillim të erës së re trevat e sotme të shqiptarëve ndodheshin nën ndikimin e dy zonave të mëdha kulturore e gjuhësore, prof. E. Çabej është shprehur qartë, se ai ishte kundër pranimin të një vije ndarëse të prerë ndërmjet këtyre dy zonave, e cila kalonte përmes asaj që është Shqipëria e sotme. Sipas tij, kjo vijë vështirë të caktohet me anë të mbishkrimeve dhe nuk mund të ketë pasur asgjëkundi një vlerë absolute. Kësaj unë do t’i shtoja gjendjen faktike sipas të dhënave të historisë. Trevat e arbërve, të cilët do të nisnin të ngjizeshin qysh nga kjo kohë si popullsi e re, ndaheshin në pesë provinca. Vija ndarëse gjuhësore për fushën administrative e fetare zbatohet kështu: Prevalitania ishte tërësisht nën latinishten, Epiri i Vjetër ishte tërësisht nën greqishten. Dardania ishte me mbizotërim të latinishtes, ndërsa Maqedonia me mbizotërim të greqishtes. Epiri i Veriut ende ishte pjesërisht me latinishten. Dy provinca (Prevalitania e Dardania) vareshin nga Salona (mbi

Shkodrën), tri të tjerat nga mitropoliti i Thesalonikut, por ky nuk lidhej me Konstantinopolin, sepse deri në shekullin V prelatët caktoheshin prej Rome. Koncili i Nikesë më 325 kishte njohur autoritetin epror hierarkik të Romës, por jo autoritetin dogmatik të peshkopit të Romës. Pa u zgatur në hollësi të tjera, duhet vënë në dukje edhe se më 732 Leoni III i shkëputi Romën nga varësia gjithë peshkopatat e Shqipërisë dhe i lidhi me Patrikanën e Kostandinopojës. Porse edhe një shekull më vonë kryepeshkopi i Durrësit vijonte të mbante lidhje me Romën.

Këto të dhëna janë të nevojshme për t'iu përgjigjur një pyetjeje të tretë: çfarë ndodhi me gjuhën e krishterimit, kur në viset tona u shfaq ndarja e dy kishave të krishtera? E para gjë që duhet nënvizuar është se, siç shihet nga të dhënat historike, kjo ndarje nuk ka qenë ashtu siç konceptohet sot, pra duke e deformuar historinë sipas së sotmes. Krishterimi nuk e ka njohur këtë ndarje në fillim, prandaj mendimi i shprehur edhe nga ndonjë shkrimtar yni me autoritet sot, se shqiptarët ishin në fillim katolikë, nuk ka asnjë bazë historike. Mbiemri *katolik*, që do të thotë 'universal', është përdorur për herë të parë në shek. III nga Tretuliani (160-240). Mbiemri *ortodoks*, me kuptimin 'drejtmendës', është përdorur për herë të parë nga Shën Jeronimi në shek. IV.

Duke hyrë në periudhën bizantine, kur popullsia shqiptare tashmë del e formuar me emrin arbër, fakti themelor mbetet që krishterimi vijonte të ishte i predikuar në gjuhë të huaj. Kjo shpjegon përse greqishtja fetare mesjetare nuk mund të zëvendësonte huazimet latine, por vetëm mund të krijonte një shtresë tjetër, tashmë të kufizuar për besimtarët e kishës së saj, dhe këtë kryesisht pas ndarjes përfundimtare të dy kishave më 1054. Megjithatë, që gjendja në trevat e arbërve vijonte të ishte e ngatërruar, e dëshmon edhe fakti që, me rënien e Mbretërisë Bullgare më 1099 dhe me rivendosjen e juridiksionit të Patrikanës së Kostandinopojës, ortodoksët shqiptarë nuk do të vreshin prej saj, por prej kryepeshkopatës së Ohrit, që u suprimua vetëm më 1767.

Si një fakt gjuhësor, që vërteton gjendjen mjaft komplekse të kësaj fushe, do të sjell vetë emrin e themeluesit të krishterimit. Shpëtimtari në hebraishten thirrej Jeshua. Grekët këtë e bënë Iesus dhe latinët e kthyen në Iezus. Më pas dishepujt e tij i shtuan mbiemrin Hristos, që është greqisht përkthim i fjalës së hebraishtes Hamashiah e të aramaishtes Meshikha dhe që do të thotë: i mirosur, i lyer me vaj të bekuar. Latinët e përkthyen "Messias", por përdorën edhe mbiemrin grek. Shqipja llogaritet e Jezuit e ka marrë nga latinishtja dhe u bë *Krishti*. Mbiemri nga ky llogaritet vjen po ashtu prej latinishtes: *i kërshtenë*, por më vonë mbiemri prej latinishtes u përzie me italishten dhe na dha *i krishtenë*, ndërsa në kohët e reja mbiemrin drejtpërdrejt prej italishtes e kemi *kristian*. Me prejardhje prej greqishtes së

re kemi trajtën *Kristoj*, dhe si emër vetjak drejtpërdrejt nga greqishtja *Kristo*. Nuk di të ketë gjuhë tjetër në Europë, në të cilën të ndeshen kaq trajta edhe për emrin: *Jezu, Jezus, Jesu, Jesus, Jisu, Jisus, Isu, Isus*. Në 'Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe' (1980), kur shpjegohet fjala "jezuit" emri është dhënë *Jesu!*. Nuk është shprehur ndonjë pohim i përcaktuar se cila do të ishte trajta normative ose zgjidhja drejtshkrimore, siç e kemi p.sh. për *parajsë* tashmë si trajtë normative. Nga vëzhgimet e mia më del se në këta dy shekujt e fundit Shqipëria e Epërme ka përdorur më shpesh *Jezu*, kurse Shqipëria e Mesme dhe Jugore ka përdorur më tepër *Krishti*.

Në fillim të mijëvjeçarit të dytë Kisha romake e riafirmoi veten në brigjet lindore të Adriatikut me disa depërtime. Tivari u bë qendër kryepeshkopate më 1077 dhe lidhej me Romën nëpërmjet Raguzës. Aty hynin peshkopatat: Shkodër, Ulqin, Drisht, Shas e Shurdhah, të cilat u shkëputën nga mitropolia ortodokse e Durrësit. Një numër minorarësh saksonë katolikë u vendosën në zonat veriore minerare të Kosovës së sotme. Pika tjetër për ripërhapjen e katolicizmit u bë Durrësi, ndonëse pikërisht aty ishte mitropolia ortodokse për Shqipërinë e Mesme. Rrjedhimisht, për dallimin e mirëfilltë ndërmjet krishterimit katolik dhe ortodoks mund të flitet në trevat tona veçse nga shekulli XII. Për të qenë të saktë, do të duhej të shtohet se një shekull më pas arbërit do të ndesheshin edhe me ortodoksinë në gjuhën serbe me qendër Pejën dhe me ortodoksinë bullgare me qendër Ohrin. Por në shekullin e Skënderbeut Shqipëria luftoi si katolike, ndërsa Fan Noli ka shpjeguar imtësisht sesi u kthyen në katolikë zotërit arbër të kohës.

Pushtimi osman dhe islamizimi i mëvonshëm e vuri në pikëpyetje seriozisht vazhdimësinë e krishterimit të arbërit. Megjithëse statistikisht kurdoherë kanë thënë se në Shqipëri ka pasur dy herë më shumë ortodoksë se katolikë, duke qenë myslimanët më shumë se tri të katërtat, dëshiroj t'i kundërshtoj këto pohime, duke thënë se nga islamizimi shpëtuan afërsisht po aq ortodoksë, sa edhe katolikë, ndërsa numri më i madh i ortodoksëve nëpër statistikisht shpjegohet me praninë e një popullsie jo të paktë vllësh, plus disa pakica të tjera ortodokse. Pikërisht nën kërcënimin osman shumëshekullor u bë një domosdoshmëri, që gjuha e krishterimit të bëhej e afërt për vendësit, domethënë ***të nisinin përkthimet për ta përdorur krishterimin arbërisht.***

Kjo nevojë e brendshme përkoi me lëvizjen e Reformacionit në Evropë, për të cilën si pikënisje merret viti 1517. Martin Luteri e përktheu Biblën në gjermanishten e zakonshme. *Kisha e Romës kundërveproi dhe Koncili i Trentit, që u mbyll më 1563, organizoi Kundërreformacionin (i cili vijoi deri më 1648). Pikërisht në këtë atmosferë të reformacionit dhe të Kundërreformacionit është përgatitur libri i Gjon Buzukut (1555) dhe është bërë heqja e tij nga qarkullimi. Për Kishën katolike problemi themelor në

Lindje u bë depërtimi përtej 'perdes së hekurt' myslimane. Patrikana ortodokse ndodhej në Stamboll, domethënë brenda 'perdes së hekurt' dhe është ky kontekst krejt i ndryshëm, që shpjegon përse ajo as merrte pjesë në kuvendet e arbërve dhe as mendonte për përkthime shqipe, rrjedhimisht përpjekjet për përkthimet e gjera shqip në fushën e ortodoksisë do të nisnin më vonë në Shqipëri dhe nga shqiptarët.

Një tip tjetër botimi i krishterimit janë katekizmat, të parin e ka përgatitur Martin Luteri më 1529 dhe për shqipen vjen i pari Lekë Matrënga më 1592; punën e tij e vijuan pa sukses Neofit Rodinoja dhe Dhimitër Delvina. Emrat e tjerë të përkthyesve shqiptarë përfshijnë Pal Hasin dhe Pjetër Budin, për të kaluar më pas te Gjon Kazazi, Z. Gualiata, V. Bazile, E. Radoja etj. Ndërsa Pjetër Bogdani zë një vend të veçantë, sepse ai ka krijuar si tip ligjëratën e krishterë në gjuhën shqipe, por që nuk pati vazhdues më tej.

Për traditën ortodokse, përveç njoftimeve të padokumentuara, vijnë me radhë Theodor Haxhifilipi, Naum Veqilharxhi, Vangjel Meksi me Grigor Gjirokastritin dhe pastaj dy emrat e mëdhenj të K. Kristoforidhit e të Fan Nolit. Shekulli XX përbën një kapitull më vete, duke u mbyllur me dy variante për herë të parë të plota të Biblës së përkthyer shqip.

Me një vështrim përgjithësues, përkthimet që kanë dhënë ndihmesë për ta shndërruar gjuhën e krishterimit në një gjuhë jo të huaj për shqiptarët, mund të përmbliidhen në katër lloje tekstesh: 1. Bibla. 2. Katekizmi dhe botimet e tjera, që me termin e sotëm do t'i quanim popullarizuese, duke arritur deri te shypi fetar. 3. Shërbesat në kishë dhe në ritet, që na kanë dhënë fjalinë e parë të dokumentuar të shqipes, formulën e pagëzimit të P. Engjëllit. 4. Ligjëratat, në kuptimin e diskursit teologjik, që nuk gjeti zhvillim, me gjithë fillimin e shkëlqyer të P. Bogdanit. Veprimtaria gojore në këtë fushë është e prejardhur prej një gjuhe të shkruar dhe prandaj studimi gjuhësor do të niset nga zanafilla librave e të gjitha dukurive.

Njohja e historisë konkrete në këtë fushë ka rëndësi për të arritur në përfundime të përpikëta. Le të më lejohet që edhe për këtë pikë t'i drejtohem përsëri prof. E. Çabejt. Në 'Hyrjen' e botimit klasik, që i ka bërë 'Mesharit' të Gj. Buzukut., thuhet ndër të tjera: "Ky tekst katolik përkon me ungjillin e Korfuzit (Grigori 1827) e të Kristoforidhit (1872), botime shqipe, që i përkasin kishës greke-ortodokse". (f. 27). Informacioni ynë i sotëm kërkon që të bëhen disa ndreqje në këtë pohim, këtu po përmend vetëm se Dhiata e re i përket nismës së protestantëve dhe jo kishës greke-ortodokse, madje Buzuku nga Dhiata e vjetër ka edhe pjesë të librave, që protestantët nuk i pranojnë, sepse i mbajnë për apokrifë.

Historia e këtyre përkthimeve përbën disa faqe shumë interesante të një veprimtarie jo vetëm fetare, por edhe të kulturës shqiptare e të librit shqip përgjithësisht.

Si përfundim, do të vë në dukje se gjuha fetare e krishterimit në shqipen e sotme përbëhet nga dy pjesë të mëdha kryesore: e para, pjesa që ka ardhur nga përdorimi i drejtpërdrejtë i një gjuhe të huaj në mjedisin e shqipes; e dyta, pjesa që është përpunuar gjatë përkthimit në gjuhën shqipe. Kjo pjesë e dytë ka luajtur një rol të madh jo vetëm për gjuhën e fesë, por edhe për gjithë zhvillimin e gjuhës shqipe si gjuhë e shkruar dhe si gjuhë kulture.

Përfundimi tjetër ka të bëjë me anën historike. Pas përmbysjeve të viteve 1990 në Shqipëri kanë nisur të qarkullojnë mjaft shkrime, të cilat përpiqen ta paraqesin sikur krishterimi është përhapur në këto treva që në shekullin e parë të erës së re. Ashtu si në historiografinë ideologjike të mëparshme, në të cilën përpiqeshin medoemos që gjithçka të ndiqte modelin e historiografisë sovjetike, ashtu po bëhet sot edhe për historinë fetare. Po përmend vetëm një shembull. Meqë në historinë ruse kishim një kryengritje të Pugaçovit, shoqëruar me interpretimin klasor përkatës, po ashtu u bënë përpjekje që lëvizjen e Haxhi Qamilit ta paraqisnin nën të njëjtën dritë në historinë e Shqipërisë. Nuk po citoj vështrimet e sotme (në thelb antishkencore sepse nuk mbështeten në asnjë dokumentim), të cilat duan medoemos ta paraqesin Shqipërinë si një ndër vendet e para të krishterimit në botë. Për këtë përmenden fjalët te letra e Shën Palit, se e ka mbushur me ungjillin deri në Ilirikum, dhe duan ta interpretojnë, se kjo do të thotë brenda në trevën e Shqipërisë së sotme. Mjafton të vështrohet një hartë e udhëtimeve të Shën Palit dhe e dërgimit të tij në fund me dhunë në Romë, për t'u bindur se ai nuk kishte asnjë mundësi të bënte predikimin në këto vise. Argumentimi gjuhësor që paraqitëm më sipër është i patundur.

Siç shihet nga letrat e tij, Shën Pali synonte në radhë të parë të kthente në anën e vet një pjesë të hebrenjve. Krishterimi i zanafillës ishte një përçarje ideologjike brenda hebrenjve. Ishte një konflikt ndërmjet idesë së izolimit dhe idesë së integritimit, konflikt i lindur si pasojë e trysisë së fuqishme asimiluese të Perandorisë Romake edhe mbi çifutët. Shën Pali mishëronte përpjekjen për ta kapërcyer qëndrimin e deriatëhershëm, se çifutët ishin populli i zgjedhur i Zotit dhe se feja e tyre ishte vetëm për këtë popull të zgjedhur. Apostujt e krishterimit synonin ta kthenin këtë në një fe universale, ku të përfshiheshin edhe popuj të tjerë, e në radhë të parë, grekët e latinët e kohës. Në të gjitha letrat e Shën Palit prej Dhiatës së re tingëllojnë qartë përpjekjet e tij pikërisht me këtë qëllim, për të kthyer nga ana e partisë së vet një pjesë të hebrenjve dhe popuj të tjerë. Por ai nuk ka qenë as në Durrës, e madje as në Apoloni. Për fat të keq, edhe ndonjë studiues me autoritet, si Theofan Popa, e ka ngatërruar Apoloninë në lindje të Selanikut

me Apoloninë e Shqipërisë. Në veçanti është i papranueshëm nocioni i një farë "hapësire iliro-biblike", të ndërtuar, me sa duket, nën ndikimin e shprehjes *Illyricum Sacrum*. Por kjo shprehje nuk ka të bëjë aspak me zanafillën e krishterimit, e aq më pak me Biblën, duke harruar se zanafilla e Biblës është një mijë vjet përpara Ilirikumit.

Këto përfundime kanë edhe pasoja praktike. Duke e pranuar se krishterimi në Shqipëri ka ardhur nga Perëndimi dhe pas shekullit të tretë, atëherë janë krejt të kota përpjekjet për të bërë gërmime arkeologjike, që do të zbulonin mbeturina të kishave të krishtera para shekullit IV në trevat shqiptare. Përpjekje të tilla kanë dështuar në zonën e Ballshit dhe nuk e vlen të përmenden. Kurse dëshmitë gjuhësore ndihmojnë për të sqaruar edhe aspekte të tjera. Përmendëm rastin e emërimit të ditës së diel, e cila në shqipen nuk iu nënshtua riemërimit sipas besimit të krishterë. Përhapja e krishterimit nga Perëndimi përkoi me fillimin e dyndjeve barbare. Ato e penguan konsolidimin e tij si një besim i përbashkët për gjithë atë popullsi, e cila mori pjesë në etnogjenezën e arbërve. Dyndjet barbare përkundrazi, ndihmuan ruajtjen e fortë të elementëve të paganizmit, që kanë ardhur deri në kohët e reja mes shqiptarëve, e konkretisht edhe ruajtjen e emërimit të ditës së diel, pa e kthyer në ditën e Zotit ose të ringjalljes së tij, siç ndodhi me italianët, grekët e rusët.

Krishterimi në Shqipëri ka ardhur nga Perëndimi. Krishterimi në Shqipëri është predikuar latinisht që në fillim dhe prandaj shtresa më e hershme e terminologjisë kishtare të shqipes është e huazuar prej latinishtes. Krishterimi në Shqipëri është përhapur pas shekullit III të erës së re. Objektet e kultit fetar të krishterë në Shqipëri nuk janë më të vjetra se shekulli IV.

Prof. Dr. Xhevat LLOSHI

THE LINGUISTIC PROBLEM OF SPREADING
OF CHRISTIANITY

Summary

The spreading of Christianity to the areas where Albanian is spoken today was a double-faceted process. On one hand there was a new way of looking at the world and man, essentially different from the pagan belief since antiquity in these regions, being with it new institutions, rites and practices unknown before, including different clothes and calendars being accompanied by an art of construction, painting, music, and decoration. On the other hand, all of these novices demanded their linguistic expression, namely lexis, syntax structure and ways of text developing, as the resistance of a religion is essentially a linguistic existence. Therefore, one may say that in the first centuries AD our areas too faced a big and complicated problem that can be called in brief as *Christianity as a new language*.

Christianity reached Albania from the West. It was preached in Latin in the beginning so that the earliest layer of church terminology was borrowed from Latin. Christianity in Albania spread after the 3rd century AD. Objects of religious Christian cult in Albania are no older than the 4th century.